

PRO INNOVATIVE SOCIAL IDEA FOR BUSINESS

SKEMA E FINANCIMIT

**NË MBËSHTETJE TË ASPIRANTËVE
PËR SIPËRMARRËS TË RINJ INOVATIV**

RREGULLORE

THIRRJA PËR PROPOZIM REF. N^o: PROISIB/2020/04





TABELA E PËRMBAJTJES

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	3
2. OBJEKTIVAT	4
3. VLERA E FINANCIMIT	4
4. KOHËZGJATJA E THIRRJES PËR SHPREHJEN E INTERESIT	4
5. RREGULLAT E THIRRJES PËR SHPREHJEN E INTERESIT	5



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Objektivi i përgjithshëm i programit PRO ISIB (innovative social ideas for business) është të sjellë një zhvillim të rinjve në këtë situatë pandemie.

Rrjedhimisht në këtë mënyrë, zgjimi i një mendimi kreativ në këtë gjendje pasive, duke krijuar sipërmarrje të cilat mund të gjenerojnë të ardhura edhe nëpërmjet punës nga shtëpia, nëpërmjet ekonomisë digjitale, do të nxisë punësimin, arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri, duke i dhënë shtysë një përshtatjeje dhe një qasje të pandalshme në tregun shqiptar të punës por edhe duke e integruar në atë ndërkombëtar.

Ky program financohet nga vetë sipërmarrësit anëtarë të Unionit të Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë, nga Dhoma e Biznesit Shqiptar të Diasporës, dhe në mbështetje nga SME ALBANIA duke u administruar nga një Komision i përbashkët i posaçëm.

Financimi do të kalojë përmes Unionit të Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë për tu transferuar direkt sipas rregullores tek sipërmarrësi apo tek furnitori në rast se sipërmarrës do të jetë vetë furnitori i zhvillimit të idesë. Bashkëpunimi në cilësinë e furnitorit dhe të klientit do të jetë detyrim i shkëmbimeve tregtare midis anëtarëve pjesëmarrës në këtë projekt.

Unioni i Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë, do të marrë pjesë me kuota në përbërjejen e shoqërisë së re për tu themeluar pas miratimit të idesë.

Unioni do të angazhohet për të gjithë mbarëvajtjen administrative ekonomiko-financiare të shoqërisë së re.

Unioni do të mund të përfaqësohet me jo më shumë se 35 % të kuotave të shoqërisë së re nën konceptin e biznesit social të themeluar.

Administrimi i shoqërisë tregtare do të kryhet vetëm nga aplikuesi i idesë.

Gjate vitit të dytë, në përfundim të vitit të parë, të aktivitetit, Unioni do të mund të shesë kuotat e veta, por jo më shumë se vlera e financuar e këtij projekti.

Sektorë të tillë si informatika, tekstilet, turizmi, zeytaria dhe agro-përpunimit, por jo vetëm marrin përparësi në vlerësimin e idesë.



2. OBJEKTIVAT

Objektivi i përgjithshëm është rritja e punësimit të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe vetëpunësimit të të rinjve ndërmjet moshave 19-34 vjeç.

Objektivat specifike të **PROISIB** si më poshtë:

- Të zhvillojë konceptin e biznesit social tek të rinjtë.
- Te ofrojë mbështetje për biznesin e ri dhe të promovojë punësimin.
- Të sigurojë financimin për fazat e para të biznesit për sipërmarrësit meshkuj dhe femra, dhe të vlerësojë qëndrueshmërinë e biznesit të tyre duke u bërë promotor i një fillimi të mbarë.
- Të zhvillojë standartin e administrimit të shoqërive tregtare dhe të drejtimit të tyre, kundrejt parimit të fitimit por edhe të ofrimit të mundësive me impakt social në vend.

3. VLERA E FINANCIMIT

Madhesia e grantit të start-up-it do të jetë deri në 3,000 Euro për projekt/person.

- Çdo person ka të drejtën e një aplikimi të vetëm.
- Projekti nuk duhet të ketë filluar.
- Mund të aplikojnë për një projekt edhe më shumë se një person.

4. KOHËZGJATJA E THIRRJES

Kohëzgjatja e thirrjes për shprehjen e interesit është deri më 20 qershor të vitit 2020 dhe nis nga data e shpalljes, sot më 05/ maj 2020.



5. RREGULLAT E THIRRJES

KRITERET E KUALIFIKIMIT DHE VLERESIMI

Skema e financuesit do të mbështesë të gjithë aspirantët për sipërmarrës të cilët zotërojnë një ide bindëse biznesi të biznesit social;

- Aktualisht janë anëtarë të Unionit të Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë dhe/ose të Dhomës së Biznesit Shqiptar të Diasporës;
- Janë shetetas shqiptarë, ose Kosovare mbi 18 vjeç, përfshirë edhe shqiptarët e diasporës;
- Janë në fazat e para të ngritjes së një biznesi të ri me kohë të plotë;
- Zotërojnë mundësinë dhe kërkojnë të drejtojnë vetë biznesin.
- Nuk kanë të dhëna kriminale

Aplikantët duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë se do të financojnë me paratë e tyre të paktën 20% të vlerës së projekt-idesë.

Shpenzimet që mund të merren në konsideratë për projekt-idenë

Duke qënë se ky projekt, bazohet në ide inovative, kryesisht të lidhur me konceptin work from home, ka në përbërje të saj koston vetëm të fuqisë punetore të zhvillimit të programimit.

Kosto të tjera të start up si, regjistrimi i sipërmarrjes, konsulta fiskale dhe ligjore do të mbulohen nga Unioni i Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë pa pagesë për një periudhë 1 -vjeçare.

Si aplikohet dhe procedurat për t'u ndjekur

Formulari i Aplikimit

Thirrjet për shprehjen e interesit do të shpallen në faqet zyrtare të YEAU dhe DHBs SHD, në qendra të tjera biznesi, media apo partnerë si dhe në rrjetet sociale.



6

RREGULLORE
MBI THIRRJEN
PËR PROPOZIM

Së bashku me thirrjen për shprehjen e interesit, personat e interesuar mund të marrin gjithashtu të gjithë informacionin përkatës mbi procedurën e aplikimit dhe doel dokumentet standarde të aplikimit.

Propozimet që do të dorëzohen duhet të përfshijnë dokumentat e mëposhtme:

- a) Formularin e Aplikimit.
- b) Planin e biznesit, sipas standarteve të parashikuara nga vetë aplin kuesi duke përmbajtur informacionin standart.
- c) Formularin e vetëdeklarimit.

Të gjithë aplikantët duhet t'i qëndrojnë në mënyrë rigoroze formatit të aplikimit dhe formateve të bashkëngjitura në këtë udhëzim.

Si dhe ku do të dërgohen propozimet

Formulari i Aplikimit, Plani i biznesit, dhe dokumenti i vetëdeklarimit, duhet të dorëzohen në kopje origjinale pranë Unionit të Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë, por edhe në formë elektronike në faqen e internetit www.yaeu.al.

Gjuha e aplikimit është ajo shqip.

Adresa për dorëzimet dorazi dhe ato nëpërmejt shërbimve postare private:

Unioni i Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë
Rr. Reshit Collaku, Nr. 1, app 8, Tiranë.

Adresa Postare për dorëzimet me email: info@yaeu.al

Propozimet e dërguara nëpërmjet rrugëve të tjera (p.sh. me faks) ose të dorëzuara në adresa të tjera do të refuzohen.

Vetëm propozimet që përfshijnë dokumentacionin e mëposhtëm do të konsiderohen të plota:

- a) Formularin e Aplikimit
- b) Planit të Biznesit
- c) Formularin e Vetëdeklarimit

Afatet e Propozimeve

Afati i fundit për pranimin e Propozimeve është 20.06.2020 në ora 16:00 sipas orës lokale. Çdopropozimi dorëzuar pas afatit mund të përfshihet për thirrjet tjetër (sipas kërkesës).

Përgjigjet do të jepen jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të afatit për pranimin e propozimeve.



7

RREGULLORE
MBI THIRRJEN
PËR PROPOZIM

Vlerësimi dhe përzgjedhja e propozimeve

Të gjitha propozimet e dorëzuara do të vlerësohen sipas hapave dhe kritereve të mëposhtme.

Kontrolli i procedurës, që ka të bëjë me respektimin e afateve, saktësinë e informacionit dhe tërësinë e dokumentacionit.

Verifikimi i kritereve sipas indikatorëve të tabelës së mëposhtme.

Pikët: - Kriteret e vlerësimit ndahen në seksione dhe nënseksione.

TABELA E VLERËSIMEVE

Kriteret kualifikimi	Verifikimi
Antarësimi	Certifikatë
Shetetas shqiptarë, mbi 18 vjeç	Dokument
Nuk kanë të dhëna kriminale	Autoçertifikim
Kriteret e projektit	
Plan Biznesi	Plan Biznesi
1. Aftësitë financuese dhe operationale të aplikantit	Deri 8 pike
2. Vlerësimi i konceptit të biznesit social dhe përfshirja	Deri 8 pike
3. Efektiviteti	Deri 8 pike
4. Qëndrueshmëria dhe ekuilibri në treg	Deri 8 pike
5. Buxheti dhe qellimi i fitimit	Deri 8 pike
Përqindja e investimit personal në lidhje me Financimin >20% (bizneset egzistuese)	Plan Biznesi Deri 20 pike
Fuqizimi i kapaciteteve në sektorët kyç të PROISIB	Plan Biznesi Deri 5 pike
Sipërmarrese Femra	Dokument Deri 5 pike
Potenciali për hapjen e vendeve të punës/nr. i vendeve (01pikë për vënd pune)	Plan Biznesi Deri 10 pike
Shpirti sipërmarrjes sociale dhe elementët inovatorë	Prezantim Deri 10 pike
Fokusi ndaj Klientit	Prezantim Deri 5 pike
Kritere të tjera sociale	Dokument Deri 5 pike

Anëtarët e Komisionit të vlerësimit të ideve për financim:

ARDIAN LEKAJ
ELISABETA KATIAJ
DANIEL GUÇE
KENNET OE SUNDIN
VALBONA MEZINI

DHOMA E BIZNESIT SHQIPTARË TË DIASPORËS
 UNIONI I SIPËRMARRËSVE SHQIPTARË TË BIZNESIT
 INSTITUTI SHQIPTAR I SME-VE
 SME ACADEMY
 PËRFAQËSUES I BIZNESIT